



PJESËMARRJA E QYTETARËVE NË QEVERISJEN LOKALE

STRATEGJI PËR PJESËMARRJE DHE IDENTIFIKIM TË NEVOJAVE



Prishtinë, dhjetor 2013

PERMBAJTJA

Në vend të parathënies.....	2
Hyrje.....	3
Angazhimi qytetar dhe rëndësia e tij.....	5
Rëndësia e angazhimit të qytetareve në çështje me interes të komunitetit.....	6
Parimet themelore të përfshirjes	7
Hapat në procesin e identifikimit të nevojave.....	10
Parimet themelore për angazhimin e qytetarëve në hartimin e politikave.....	15
Në vend të përfundimit.....	17

NË VEND TË PARATHËNIES

Një ndër sfidat me të cilat ballafaqohen qeveritë në përgjithësi, dhe qeverisja në Kosovë, në veçanti, është rritja pjesëmarrjes së publikut në vendimmarrje dhe rritja e bashkëveprimit në mes institucioneve dhe grupeve të interesit në vecanti. Edhe pse nuk ka formule ose metode standarde, te pjesëmarrës se qytetareve ne vendimmarrje, megjithatë ka praktika dhe shembuj te suksesshëm që duhet ndjekur.

Shembujt e shumtë të angazhimeve direkte të banorëve, komunitetit në përgjithësi në krijim të politikave dhe vendimeve lokale, tregojnë edhe për cilësi dhe efektshmëri më të madhe të po atyre vendimeve. Përfshirja e qytetareve në procese vendimmarrëse nuk duhet te shihet dhe interpretohet vetëm si obligim ligjor por edhe interes institucional, për të rritur transparencën, llogaridhënien dhe përgjegjshmërinë karshi qytetarëve.

Me gjithë përparimet e dukshme, sfidat në përfshirjen ose angazhimin efektiv të qytetarëve në vendimmarrje janë evidente. Në shumë komuna të Kosovës, qytetarët nuk marrin pjesë, në disa të tjera pjesëmarrja është simbolike, në vendimet që ndikojnë në jetën e tyre të përditshme. Mos pjesëmarrja shpesh është pasoje e të mungesës se besimit në institucionet lokale.

Metodë më e përshtatshme dhe me efektive në zbutjen e këtij hendeku të bashkëpunimit dhe bashkëpërfshirjes është komunikimi në mes palëve, inkurajimi i tyre që përmes përdorimit të mekanizmave ekzistues ligjor të rrisin njohuritë e tyre të pjesëmarrjes dhe rrisin bashkëveprimin dhe besimin në institucionet lokale.

Ky dokument, i shkruar në formë strategjie për identifikim të nevojave të qytetareve, në mes tjerash ofron informata me rëndësi rreth :

- Procesit të angazhimit efektiv dhe funksional të qytetarëve ;
- Komunikimit dhe zhvillimit të besimit në mes komunave dhe qytetarëve ;
- Mënyrave të inkurajimit dhe angazhimin konsistent dhe afatgjatë qytetarëve në proceset vendimmarrëse në nivel lokal, si dhe
- Ofron rekomandime konkrete për pjesëmarrje të gjerë qytetare ne vendimet komunale te cilat afektojnë jetën e tyre.

Ky dokument/strategji do të ndihmojë organizatat joqeveritare, të cilat zhvillojnë ose implementojnë projekte në fushën e qeverisjes lokale, për të rritur angazhimin efektiv të qytetarëve dhe grupeve të interesit në vendimmarrjen lokale në përgjithësi, në vendime për projekte konkrete për komunitetin në veçanti.

Ky dokument/strategji do të mund të përdoret edhe nga; Komunat e Kosovës, zyrtarët lokalë të zgjedhur dhe të emëruar , udhëheqësit te këshillave te fshatrave, përfaqësues te komunitetit, qytetarë, media etj.

HYRJE

Që nga fillimi i vitit 2012, ATRC ka filluar zbatimin e projektit: “Qytetarët Aktiv – Komuna Llogaridhënëse dhe Transparente”, në katër komuna të Kosovës: Gjilan, Kamenicë, Novobërdë dhe Viti, projekt i përkrahur nga Qendra Ndërkombëtare Olof Palme.

Gjatë dy viteve të implementimit të projektit ATRC në bashkëpunim me katër komunat e lartpërmendura ka themeluar dhe fuqizuar grupe të qytetarëve dhe grupe të shoqërisë civile në identifikimin dhe adresimin e kërkesave dhe nevojave të qytetarëve në organet gjegjëse komunale.

Procesi i identifikimit të nevojave të qytetarëve, i nisur nga ATRC është mirëpritur sidomos nga autoritetet komunale dhe përfaqësuesve të Këshillave Lokale të Novobërdës dhe Kamenicës. Përkushtimi i përbashkët i të dyja palëve ka mundur përfshirjen e të gjitha fshatrave në procesin e identifikimit dhe prioritarizimin e nevojave të komunitetit.

Edhe pse gjatë vitit 2012 komunat e lartpërmendura kishin filluar organizimin e takimeve me komunitetin, megjithatë në vitin 2013, për herë të parë në bashkëpunim me ATRC kërkesat e banoërëve janë renditur dhe sistemuar në një publikim të vetëm.

Ndikimi kryesor i projektit do të jetë themelimi i Këshillave Konsultativ si mekanizma për bashkëpunim të qëndrueshëm dhe të vazhdueshëm ndërmjet autoritete lokale dhe qytetarëve.

Dokumenti/strategjia do të jetë një vegël e rëndësishme për organizimin e shërbimeve publike për dhe përbrenda komuniteteve, që është edhe temë e rëndësishme në rritje të pjesëmarrjes së qytetarëve në vendimmarrje dhe rritjen e llogaridhënies dhe transparencës së qeverive lokale.


ANGAZHIMI QYTETAR DHE RENDESIA E TIJ

Niveli i pjesëmarrjes së qytetarëve në proceset vendimmarrëse përcakton edhe nivelin e demokracisë së vendit. Pjesëmarrja dhe angazhimi qytetarë në proceset vendimmarrëse mund të konsiderohet i realizuar vetëm kur vendimet lokale bazohen mbi interesat qytetare edhe atë mbi bazën e konsultimit të gjerë publik. Kjo nënkupton se qytetarët janë të përfshirë në mënyrë aktive në përcaktimin e çështjeve, identifikimin e zgjidhjeve, dhe zhvillimin e prioritetëve për planet dhe vendimet lokale.

Është në përgjegjësinë dhe rolin e komunave të Kosovës, që duke shfrytëzuar mundësitë ligjore në dispozicion të gjejnë forma të përfshirjes së qytetarëve në qeverisjen lokale, duke përfshirë dhe jo kufizuar në rolin si bashkëpunëtor, përkrahës mbështetës në komunikim me qytetare etj.


Rezultati i partneritetit në mes komunës dhe qytetarëve është jo vetëm detyrim që duhet plotësuar por duhet të shihet si nevojë që duhet praktikuar dhe jetësuar në secilin vendim dhe politike lokale.

Praktikat e përfshirjes së qytetareve në vendimmarrje tregojnë se ky proces në përgjithësi përfshinë pesë elemente bazë/thelbësore:



RËNDËSIA E ANGAZHIMIT TË QYTETAREVE NË ÇËSHTJE ME INTERES TË KOMUNITETIT

Angazhimi dhe përfshirja e qytetarëve në vendimmarrje lokale është e një rëndësie të veçantë, për institucionin dhe komunitetin. Një proces që angazhohet qytetarët prodhon rezultate të shumta dhe të nduar-ndurshme, si:



PARIMET THEMELORE TE PËRFSHIRJES

Sigurimi i pjesëmarrjes efektive të qytetarëve në qeverisjen lokale, në të shumtën e rasteve varet nga mjetet, teknikat dhe metodat e aplikuara. Nuk ka ndonjë rregull ose formulë të përdorimit të teknikave dhe metodave të përfshirjes, edhe pse ato duhet të zhvillohen sipas rastit, çështjes dhe kontekstit.

Forcimi i raporteve në mes qytetareve dhe institucioneve lokale duhet të kuptohet si investim në politika me të mira lokale, të cilat janë themeli i qeverisjes së mirë. Kjo praktikë krijon mundësinë e qeverisë lokale që vendimmarrja lokale të jetë produkt i konsultimit të gjerë me publikun dhe me grupet e interesit. Në anën tjetër përfshirja e publikut në vendimmarrjen lokale forcon transparencën, rrit ndërveprimin në mes qytetarëve dhe komunës, si dhe rrit cilësinë e përfaqësimit të interesave publike në institucionin e komunës.

Në krijimin ose zhvillimin e raporteve me qytetarë, institucionet lokale duhet të sigurojnë realizimin e disa parakushteve të cilat ndikojnë drejtpërdrejtë në përfshirjen e qytetareve në proceset vendimmarrëse, si psh. analizën nëse:

Informacioni është i plotë, objektiv, i besueshëm, relevant, i lehtë për tu qasur dhe i kuptueshëm nga të gjithë





Konsultimi me publikun ka qëllime të paracaktuara dhe gjithashtu rregulla të paracaktuara të konsultimit dhe marrjes për baze të kontributit



Pjesëmarrja u jep kohë dhe fleksibilitet të mjaftueshëm qytetareve për të analizuar dhe propozuar ide inovative si dhe mekanizma për përfshirjen e tyre në politikat lokale.

Disa nga aspektet themelore te angazhimit te suksesshëm qytetar, përfshijnë:





HAPAT NE PROCESIN E IDENTIFIKIMIT TE NEVOJAVE

Pjesëmarrja qytetare është një mjet/metodë e cili ndihmon përfaqësuesit e komunitetit të jenë pjesë e vendimmarrjes për projektet që janë me interes të gjerë publik. Pjesëmarrja qytetare mund të aplikohet në shumë çështje apo raste, si psh: ndërtimi i një fushe sporti në një lagje, ndërtimi i një parku lojërash, e deri te vendimet lokale dhe politikat publike. Çështje më të ndjeshme dhe me te mëdha mund të kërkojnë më shumë planifikim dhe më shumë përkushtim në sigurimin e angazhimit qytetar. Varësisht nga çështja për të cilën ju jeni duke punuar, ju mund të zgjidhni edhe teknikat të cilat ju sigurojnë realizimin e qëllimeve tuaja. Gjate zhvillimit të Planit të angazhimit qytetare ju duhet të keni parasysh teknikat standarde, si:

HAPI 1 : PËRCAKTIMI I ÇESHTJES

Pyetja kryesore që shtrohet është se cili është problemi apo çështja specifike që ju dëshironi ta adresoni. Është e rëndësishme që problemi i identifikuar të transformohet në një çështje për të cilën komuniteti ka nevojë për të adresuar dhe zgjidhur. Gjate fazës së përcaktimit të çështjes duhet të kihet parasysh nëse çështja ka zgjidhje dhe nëse është e realizueshme. Nëse ju keni identifikuar një problem të vogël, por që ka nevojë për adresim të shpejt, atëherë informo, motivo dhe angazho qytetarët për realizimin e saj.

HAPI 2 : IDENTIFIKIMI I QËLLIMIT DHE INTERESIT TE PËRFSHIRJES QYTETARE

Shpesh i kemi bërë pyetje vetës: çka i shtyn njerëzit që t'i bashkohen një nisme, fushate, koalicioni ose iniciative dhe pse ju keni nevojë për përfshirjen e tyre në nismën tuaj? Kjo analizë e përfitimeve dhe humbjeve, duhet të bëhet qysh në fazën fillestare të angazhimit qytetarë, si një nga mënyrat e evitimit të te papriturave.

Disa pyetje të cilat ju ndihmojnë ju në identifikimin e qëllimeve tuaja :

- Dëshironi të informoni njerëzit lidhur me qëllimin e nismës tuaj, apo dëshironi të kërkon angazhim të drejtpërdrejtë në idenë e jua? A keni nevojë për më shumë informacion nga qytetarët për të marrë vendimin? Etj. Teknikat më të shpeshta të informimit përfshijnë sondazhet e opinionit publik, fletëvlerësimet, konsultimet publike, dëgjimet publike etj.
- A doni të merrni reagime publike në lidhje me një projekt , program apo vendim? A dëshironi të nxisni debat publik në lidhje me çështjen e identifikuar? Metodatat kryesore të përdorura për të konsultuar publikun përfshijnë: takime me komunitetin, tryeza të rrumbullakëta, diskutime në fokus grupe etj.
- A dëshironi të punoni drejtpërdrejtë me qytetarë gjatë gjithë procesit të vendim -marrjes, duke përfituar nga përvoja dhe rekomandimet e tyre? Mjetet kryesore të angazhimit të publikut përfshijnë: takime publike, dëgjime publike.

Komunat e Kosoves gjithnjë e më shpesh organizojnë dëgjime publike dhe takime publike me grupe të interesit dhe qytetarë në çështje të cilat konsiderohen me interes publik. Sigurohuni që grupi që ju

përfaqësoni të jetë një prej pjesëmarrësve në aktivitetet e planifikuara. Ju mund të zhvilloni praktika të ndryshme për inkurajimin e pjesëmarrjes qytetare në këto lloj takimesh, si:

- 1 . Organizimin e një serie diskutimesh në tryezë të rrumbullakët për identifikimin e çështjeve kryesore të komunitetit ;
- 2 . organizimin e hulumtimi për vlerësimin e nevojave të identifikuara të komunitetit
- 3 . Organizimin e një konference, takimi me komunitetin për publikimin e rezultateve.

Për të siguruar pjesëmarrjen e qytetarëve në të gjithë procesin e diskutimit dhe vendimmarrjes, ju duhet të vendosni ekipin, i cili mbi bazën e parimeve:

1. zgjedh mjetet për pjesëmarrjen e qytetarëve ;
2. identifikon dhe rekruton pjesëmarrësit ;
3. hulumton dhe analizon informatat ;
4. harton standardet dhe kriteret për vlerësim ;
5. raporton rezultatet e procesit dhe
6. jep rekomandime bazuar në rezultate .

HAPI 3 : IDENTIFIKIMI I MJETEVE PËR PËRFSHIRJE TË QYTETARËVE

Ka një mori mjeteve që ju mund t'i përdorni për angazhimin e qytetarëve në nismën ose idenë e jua. Gjithmonë duhet të kihen parasysh që teknikat dhe metodat e përdorura për identifikim dhe përfshirje qytetare të jenë të orientuara në katër qëllimet baze: informo, konsulto, angazho dhe bashkëpunohet.

1. Informo

Intervistat dhe Sondazhet

Intervistat dhe sondazhet janë metoda për identifikimin dhe prioritizimin e çështjeve brenda një komuniteti. Përmes këtyre metodave ju i jepni vendim-marrësit informacion të besueshëm, dhe të vlefshëm për çështjen që ju preokupon dhe vlerësoni ndikimin e politikave dhe programeve komunale në komunitet . Duke përdorur këtë informacion, ju mund të:

- përshkruani karakteristikat demografike të komunitetit/zonës ;
- Vlerësoni kërkesat prioritare të qytetarëve,
- Siguroni hapësirë dhe mundësi qytetarëve për të shprehur mendimet e tyre ;
- Siguroni mbështetje për politikën apo iniciativën e juaj,

- Vlerësoni ndikimin real të programeve tuaja, ndikimin e politikave dhe shërbimeve të ofruara në komunitet .

Ne përgjithësi, ka dy qasje kryesore të cilat përdoren për mbledhjen e të dhënave nga komuniteti, të cilat janë: kontakt kyçe intervista dhe anketime .

Intervistat të drejtpërdrejta

Intervistat të drejtpërdrejta janë diskutimet me individë të cilët kanë njohuri të dorës së parë rreth problemeve të komunitetit dhe përvojë në zgjidhjen e tyre. Liderët e komunitetit, persona me ndikim në lagje, zonë etj mund të jenë persona me interes për intervistim, të cilët posedojnë njohuri personale dhe përvojë, të cilët kanë informacione burimore për shqetësimet e banoreve, dhe komunitetit në përgjithësi.

Për shembull, nëse ju jeni duke krijuar politika zhvillimore ose rregullore komunale për transparencë, kontaktet kyçe mund përfshijnë: gazetaret, OJQ-te etj.

Sondazhet

Qëllimi i sondazheve është mbledhja sistematike e të dhënave nga qytetarë ose një grup i qytetarësh. Sondazhet mund të përdoret për të mësuar më shumë rreth komunitetit, si : karakteristikat demografike , të tilla si mosha , gjinia, të ardhurat personale, niveli arsimor, kënaqësia në lidhje me shërbimet komunale si dhe propozimet ose rekomandimet për ndryshim të politikave dhe rregullove komunale. Para fillimit të sondazhit, është e domosdoshme të bëhet përzgjedhja e grupeve të qytetareve të cilët ju dëshironi t'i targetoni, zonën në të cilën ju dëshironi të zhvillonit sondazhin dhe informatat specifike që dëshironi t'i merrni nga sondazhi. Për shembull , në qoftë se ju dëshironi të identifikoni nevojat e qytetarëve të gjithë territorit të Komunes, atëherë duhet të kontaktoni liderët e fshatrave, këshillave të Fshatrave ose individë me reputacion në komunitet.

Sondazhet mund të shpërndahen në mënyra të shumta , që përfshijnë: me email, shpërndarja përmes postës, përmes telefonit, takime sy me sy, plotësimi online në ëeb-faqe etj.

Dëgjimet publike

Dëgjimet publike janë metoda të rëndësishme të diskutimit dhe identifikimit të nevojave të qytetarëve. Dëgjimet publike janë të nevojshme në rastet kur Komuna fillon me procesin e krijimit ose ndryshimit të politikave apo rregulloreve. Dëgjimet publike janë forume të rëndësishme përmes të cilave zyrat komunal diskutojnë dhe dëgjojnë kërkesat, vërejtjet dhe sugjerimet e komunitetit rreth një çështjeje. Komunitet mund të organizojnë dëgjime publike të fokusuar në çështje specifike me pjesëmarrje nga individë dhe grupe qytetare të interesit.

2. Konsulto

Intervistat jo formale

Intervistat joformale mund të përdoren për të gjeneruar dhe prioritarizuar kërkesat dhe nevojat e qytetarëve. Intervistat, veçanërisht janë të dobishme për të mbledhur ide nga një grup i madh apo nga njerëz të cilët për shkak të largësisë fizike nuk mund të marrin pjesë në takimet e organizuara nga Komuna.

Tryeza të rrumbullakëta (fokus grupe)

Fokus grupet janë një mënyrë e fuqishme për të mbledhë idetë, mendimet, përvojat ose qëndrimet e qytetarëve rreth çështjeve të komunitetit. Diskutimet mes pjesëmarrësve në fokus grupe, shpesh, ju japin njohuri të reja, përtej perspektiva individuale. Pjesëmarrësit në fokus grupe duhet të zgjidhen në bazë të njohurive dhe përvojave të tyre personale në çështje të njëjtë, të cilat janë edhe objekt i diskutimit. Krijimi i fokus grupeve në çështje të ndryshme komunale, si: fokus grupi për politika rinore lokale, fokus grupi për çështje urbanistike, fokus grupi për buxhetim me pjesëmarrje etj, do t'i ndihmonte komunes në komunikimin e vazhdueshëm me grupet e interesit në çështje të interesit të dyanshëm. Sa më shumë fokus grupe të krijuar dhe funksionale aq më shumë pjesëmarrje qytetare në vendimmarrje.

3. Angazho

Forume Publike

Krijimi ose themelimi i forumeve publike siguron hapësirë qytetarëve ose grupeve qytetare për të shqyrtuar dhe diskutuar me përfaqësuesit e zgjedhur një çështje me interes lokal si: transporti publik, kujdesi shëndetësor, taksat komunale, infrastruktura rrugore etj. Shumë shpesh ndodh që qytetarët duke mos pasur qasje në informata ose informata burimore në lidhje me një çështje specifike, nuk kanë pasur mundësi që të ndërtojnë një qëndrim Pro ose kundër një ideje, nisme apo propozimi. Forumet Publike krijojnë mundësinë çdo qytetari të interesuar që t'i paraqesin pikëpamjet e tij në lidhje me një çështje të caktuar ose edhe t'i ndryshojë ato si rezultat i argumenteve të marra nga pjesëmarrësit tjerë. Forumet publike mund të jenë afatgjate dhe ad-hok, gjithmonë sipas çështjeve që trajtohen dhe dinamikës së zgjidhjes së saj.

4. Bashkëpunu

Krijimi i Task Forcave ne Komunitet

Task Forca ne Komunitet nënkupton krijimin e një grupi vullnetarësh, aktivistesh ne komunitet te cilët angazhohen ne aktivitete lokale, duke përfshirë përcaktimin dhe prioritarizimin e çështjeve, mbledhjen e informacionit, krijimin e rekomandimeve, zhvillimin hapave të veprimit, dhe zbatimin e planit të praktike. Për shkak të mos-pasjes së grupeve ose mekanizmave zyrtar të themeluara në fshatra dhe lagje, përfaqësimi i tyre bëhet përmes liderëve të komunitetit, të cilët shpesh janë të emëruar ose të vetë-emëruar. Themelimi i Task Forces do të krijonte hapësirë për individë dhe grupe të ndryshme qytetare që të japin kontributin në çështje të interesit të përbashkët.

HAPI 4 : IDENTIFIKIMI INDIVIDËT DHE GRUPEVR QË DUHET PËRFSHIRE

Pjesëmarrja qytetare ne vendimmarrje komunale ne përgjithësi, pjesëmarrja ne takimet publike, ne dëgjimet publike etj, ne te shumtën e rasteve vlerësohen si te dështuara për shkak te pjesëmarrjes simbolike te qytetareve. Për të siguruar pjesëmarrje efektive të qytetarëve, duhet të analizojmë se kush duhet të ftohet për të marrë pjesë në aktivitetet dhe nëse pjesëmarrja e planifikuar siguron përmbushjen e qëllimeve tuaja. Çdo pjesëmarrës sjell në takim informacione të vlefshme, pikëpamje, përvojë jetësore etj, por jo të gjithë kanë informacione në lidhje me çështjen, subjektin e takimit. Ju duhet të dini qëllimin e organizimit të takimit dhe mbi këtë bazë të vlerësoni edhe pjesëmarrësit ose grupet që mund t'i kontribuojnë më së miri çështjes në diskutim. Është shumë e rëndësishme që të sigurohet gjithë përfshirje e të gjitha palëve të interesuara në të gjitha fazat e procesit.

Grupet dhe individët që ju mund t'i vlerësoni të përshtatshëm për t'i përfshirë, mund të jenë: grupet tashme të themeluara dhe ekzistuese, si Këshilla te Fshatrave; anëtarë të Kuvendit komunal, përfaqësues të biznesit , përfaqësues të mediave , përfaqësues nga organizata joqeveritare. Grupe tjera qe janë potencialisht të përshtatshëm për përfshirje janë: gratë , minoritetet , pensionistet , te rinjtë etj.

HAPI 5 : KRIJIMI I NJË AMBIENTI POZITIV PËR ANGAZHIMI QYTETAR

Për të inkurajuar pjesëmarrjen e vazhdueshme qytetare, nuk mjafton vetëm informimi ose ftesa për pjesëmarrje. Për të siguruar angazhim të vazhdueshme të qytetareve është e domosdoshme të krijohet bindja se kontributi i tyre merret dhe do të merret parasysh gjate zhvillimit te politikave dhe vendimeve lokale. Takimet pa agjende të paracaktuar dhe pa ndonjë qëllim të paracaktuar shpesh nuk prodhojnë rezultate ose prodhojnë kundër efekte, shpesh në demotivimin e qytetareve për të vazhduar angazhimin e tyre në qeverisjen lokale.

HAPI 6 : RUAJ dhe SIGURO LINJE TE RREGULLT TE KOMUNIKIMIT

Komunikimi me grupin që ju përfaqësoni ose që synoni t'i mbani të informuar, duhet të jetë i vazhdueshëm dhe i përshtatur nevojave dhe kërkesave te grupit. Informimi i rregullt dhe i vazhdueshëm ndikon në rritjen e ndërgjegjësimit publik në lidhje me çështjet që janë subjekt i informimit tuaj dhe në të njëjtën kohë ndikon në rritjen e motivit të qytetareve për të vazhduar angazhimet në qeverisjen lokale. Një nga mënyrat themelore dhe më të thjeshta për te mbajtur publikun te informuar është përmes buletinit. Buletinet mund të jenë mjete efikase në shpërndarjen e informatave burimore te qytetaret ose grupet e interesit, te cilat mund t'i kontribuojnë ne te njëjtën kohe informimit dhe përfshirjes qytetare ne vendimmarrje lokale.

PARIMET THEMELORE PËR ANGAZHIMIN E QYTETARËVE NË HARTIMIN E POLITIKAVE

Përkushtimi

Përkushtim i forte institucional për casje ne informacion, hapësire për konsultim te gjere publik dhe pjesëmarrje aktive e qytetareve është një prej parimeve themelore te pjesëmarrjes në bërjen e politikave publike.

Te drejtat

Te drejtat e qytetarëve për qasje në informata, e drejta për te kundërshtuar vendimet dhe politikat e aprovuara, e drejta e konsultimit dhe pjesëmarrjes aktive në hartimin e politikave duhet të rregullohen me ligj apo politike.

Qartësimi

Objektivat rreth informacionit, konsultimit dhe pjesëmarrjes aktive te qytetareve gjatë hartimit të politikave duhet të jenë të përcaktuara mirë nga fillimi. Gjithashtu edhe rrolet dhe përgjegjësitë e qytetarëve (në ofrimin e kontributit) dhe qeverisë (në marrjen e vendimeve për të cilat ata janë të përgjegjës) duhet të jetë e qartë për të gjithë.

Koha

Konsultimi publik dhe pjesëmarrja aktive e qytetareve duhet të aplikohen sa më shpejt dhe sa me herët që të jetë e mundur, në mënyrë që të krijohet hapësirë dhe mundësi qytetareve që të jenë të përfshirë qysh në fillim të procesit të krijimit të një politike.

Objektiviteti

Informacioni i siguruar nga qeverisja lokale gjatë hartimit të politikave duhet të jetë objektiv, i plotë dhe i qasshëm nga publiku. Të gjithë qytetaret duhet të kenë trajtim të barabartë, kur ushtrojnë të drejtat e tyre për qasje në informata dhe pjesëmarrje.

Burimet/resurset

Burimet adekuate financiare, njerëzore dhe teknike janë të nevojshme në qoftë se dëshironi që informacioni publik, konsultimi dhe pjesëmarrja aktive të jep efektet e saja pozitive. Zyrtarët qeveritarë duhet të kenë aftësitë dhe trajnimet adekuate për komunikim dhe bashkëpunim me qytetare.

bashkërendimi

Iniciativat për informim publik, hapësirat për dhënie të kontributit dhe konsultimi me qytetar duhet të jenë në koordinim të vazhdueshëm në mes institucioneve lokale dhe grupeve qytetare.

Përgjegjësitë

Institucionet kanë obligim që të japin llogari për nivelin e përfshirjes së kontributit qytetare në politikat publike, kontribut i dhënë kryesisht përmes pjesëmarrjes në konsultimet publike dhe pjesëmarrjes aktive në aktivitete tjera specifike. Të siguroarit që procesi i bërjes së politikës është i hapur, transparent dhe gjithë përfshirës është bazament i qeverisjes së mirë.

Vlerësimi

Qeveritë shpesh kanë nevojë për informacion dhe kapacitete humane për të vlerësuar performancën e tyre në komunikim me qytetare, në mënyrën e shpërndarjes së informacionit, organizimit të konsultimit publik, dhe angazhimit të qytetarëve etj, në mënyrë që të përshtaten me kërkesat e reja dhe ndryshimin e kushteve për hartimin e politikave.

Qytetaria aktive

Qeveritë përfitojnë nga qytetaria aktive dhe nga një shoqëri civile dinamike. Angazhime përplotësues duhet të merren në rritjen e numrit të qytetarëve të cilët kanë qasje në informacionin publik, rritjen e pjesëmarrjes efektive në vendimmarrje, rritjen e ndërgjegjësimit publik, dhe mbështetje në ndërtimin e kapaciteteve në mesin e organizatave të shoqërisë civile.

NE VEND TE PËRFUNDIMIT

Një shoqëri civile mirë e organizuar dhe e përfshirë në të gjitha proceset vendimmarrëse në nivel lokal, mund të ndikojë drejtpërdrejte në nxjerrjen e vendimeve lokale më të mira, në shpërndarjen efikase dhe proporcionale të buxhetit komunal, në mënyrën e shpenzimit të parasë publike, në zbatimin më të përgjegjshëm të legjislacionit komunal, dhe në përmirësimin e cilësisë së jetës së komunitetit në përgjithësi.

Sugjerimet dhe shembuj e përdorura dhe të përfshira në këtë udhëzues ofrojnë informata bazike të përfshirjes qytetare në vendimmarrjen lokale në përgjithësi dhe planifikimin me pjesëmarrje në veçanti. Dokumenti mund të përdoret nga organizatat e shoqërisë civile dhe komunat e Kosovës si një lloj udhëzuesi për rritjen e përpjekjeve institucionale në angazhim të efektshëm dhe të vazhdueshëm qytetar në qeverisjen lokale.

Ky publikim është pjesë e projektit: *“Qytetarët Aktiv – Komuna Llogaridhënëse dhe Transparente”*

i implementuar nga ATRC, përkrahur nga: The Olof Palme International Center.

Përmbajtja e këtij publikimi reflekton qëndrimet e autorit dhe jo domosdoshmerisht qëndrimet e donatorit.



Ndërsa është implementuar nga Advocacy Training and Resource Center – ATRC

